




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neneve 17; 38, 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2025 miratoi këtë;

VENDIM PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI

Neni 1

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin “Furnizimi me mekanizëm bujqësor” në vlerë 42,857.00€ në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

Neni 3

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 142,857.00€, financon shumën 100,000.00€ apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shuma e përgjithshme e participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 42,857.00 apo 30% e vlerës së projektit.

Neni 4

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës dhe i njëjti bën pjesë në kategorinë e subvencioneve dhe transferove në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – kodi i programit 47005.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, si dhe Ligjit Nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot. 01-400/03-0036072/25
Podujevë, datë; 26. 06. 2025

